



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	27.03.2024
REFERENC-Ë:	6691/2023 - ZSP- 2024
PËR/ZA/TO:	„SYLA GROUP” SH.P.K , Rruga 17 Shkurti, Klinë e Poshtme , Skenderaj
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL- së
NGA/OD/FROM:	Mevlane KUKA , Zyrtare për planifikim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe Dokumentacionin tekniko-investiv, për shfrytëzim të ujit nga pusi për bazën mobile të prodhimit të betonit me Nr. të protokollit: 6691/23, datë : 14.11.23 të parashtruar nga „SYLA GROUP” Sh.p.k, Kline e Poshtme , Skenderaj dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalhog Sekretara / Office of the General Secretary

LU .

Datë: 27.03.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës "SYLA GROUP" SH.P.K, Kline e Poshtme, Skenderaj , për **Leje Ujore** - shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga Pusi, për bazën mobile të prodhimit të betonit me nr protokolli: 6691/23, datë : 14.11.2023, sipas kushteve vijuese:

Leja Ujore jepet me këto kushte:

1. Sasia maksimale për shfrytëzim e ujit nëntokësorë nga pusi është $Q_{max} = 2.70$ l/s (dy pikë shtatëdhjetë litër për sekondë), sipas Dokumentacionit të dorëzuar Tekniko – Investiv, në parcelën kadastrale, P-720-150025-01443-1, Kline e Poshtme , Skenderaj , Pusi me koordinata:(Y=7 483 344.48 ; X= 4 734 929.26);
2. Pala duhet te instalon ujëmatësit brenda 15 ditëve dhe te njëjtën duhet ta paraqet me dëshmi në Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës (MMPHI) në Autoritetin Rajonal të Pëllgjeve Lumore (ARPL) ku dhe përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), dhe sasinë vjetore (m^3 /vit);

3. Për sasinë e shfrytëzuarë pala obligohet, që për çdo gjashtë muaj, të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së Lejes Ujore;
4. Nr. Serik i ujëmatësit, i prezantuar në ARPL/MMPHI, dhe i njëjti pra nuk mund të ndryshohet për ndërrimin e mundshëm të tijë duhet informuar Organi përgjegjës që e ka lëshuar këtë vendim;
5. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
6. Për këtë pala obligohet të raportoj shfrytëzimin, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
7. Afati i lëshimit të Lejes Ujore është 5 (Pesë) vite me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
8. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
9. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të Lejes Ujore;
10. Leja Ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar nga pala për aplikim ka shqyrtuar: Dokumenti tekniko – investiv i pusit të ujit në parcel nr P-720-150025-01443-1;00443-2,00443-3,00443-4, Marrëveshje bashkëpunimi “SYLA GROUP” SH.P.K dhe Alpha Zero1 Sh.p.k, Çertifikata e regjistrimit të biznesit ” SYLA GROUP ”Sh.p.k, Kopja e Planit, Vendim-Pëlqim Mjedisor, Licencë- Kompani e licencuar, “Gjeodeti” sh.p.k, Kopja e lejes së njoftimit të Blerim Halilaj, Harta e Situacionit të Betonjerkës, Harta e situacionit, Situacioni Gjeodezik, Situacioni i terenit, Koordinatat e matura për situacionin, Çertifikata e regjistrimit të biznesit “ Alpha Zero1 ” sh.p.k, Diplome e Esat Bislim Mehani, Diplome e Veton Liman Elshani.

Faturat e paguara me rastin e aplikimit për (Kushte Ujore, Pëlqim Ujor, Leje Ujore); CD-në.

Andaj bazuar në atë siç u tha më sipër, bazuar në Legjislacionin e ujërave të Kosovës; bazuar në shikimit në vend me ç’rast është mbajtur edhe procesverbali i nënshkruar nga të dyja palët, është vendosur si në dispozitiv.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në inicimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 6691/23 - ZSP- 2023, datë: 27.03.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës së Skenderajt ;
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

